




REPUBLIKA E KOSOVËS	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPSTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	180/17
Nr. i fq. / Br. st	- 10 -
Data / Datum	29. 06. 2017
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -V- (E PESTË) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 25 MAJ 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beqa, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Mentor Ferizi dhe Selim Rrustemi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e tij lidhur me realizimin e të drejtës ligjore të qytetarëve që ka të bëjë me shqyrtimin e trashëgimisë, për faktin se për tokat të cilat ndodhen në zonën e komasacionit disa pronarëve u jepet e drejta që ta shqyrtojnë trashëgiminë e disa të tjerëve jo. Andaj lidhur me këtë ai kërkoi sqarime se në bazë të cilit ligj iu mohohet kjo e drejtë qytetarëve.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së - dha përgjigje në pyetjen e anëtarit të kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – në kuadër të diskutimit për rendin e ditës paraqiti tri pika shtesë që të futen në rend të ditës për shqyrtim.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit – paraqiti një kërkesë të parashtruar nga Këshilli Profesional i Mjekësisë, që pasuria jofinanciare e shëndetësisë e cila është joaktive të hiqet dhe e njëjta të qitet në ankand publik sepse ajo po shkakton pengesa në objektin e QKMF-së.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – propozoi që propozimi për rishikimin e buxhetit të komunës të mos futet në rendin e ditës, kjo për faktin se duhet të ketë respekt për anëtarët e kuvendit, kur dihet se Drejtoria e Buxhetit po i neglizhon gjërat sepse për rishikimin e buxhetit ajo ka qenë në dijeni se afati i fundit është 30 maji. Pastaj pyeti kryetarin e komunës për dukurinë e vetëpunësimit të disa drejtorëve të drejtorive komunale në administratën komunale siç është rasti i fundit me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dhe për këtë pyeti se ky vetëpunësim a është ligjor apo jo. Në fund ajo e uroi profesoreshën Selvete Sholla për pensionimin e saj duke e vlerësuar lart kontributin e saj dhe duke i dëshiruar shëndet dhe suksese në të ardhmen.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – pasi e falënderoi Drejtorinë e Shërbimeve Publike për heqjen e deponive të mbeturinave, shtoi se është mirë që tani Drejtoria e Inspektimeve të dalë

në vend ngjarje që t'i ndalojë qytetarët në hedhjen e mbeturinave në këto lokalitete, të cilat janë pastruar.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se pika në të ndryshme kanë ardhur me vonesë dhe këto pika si të tilla nuk duhet të futen në rend të ditës, pasi që është krijuar një praktikë e keqe e funksionimit të kuvendit ku shumica e pikave të rendit të ditës vijnë ditën e mbajtjes së mbledhjes dhe kështu shpeshherë kuvendi merr vendime jo të duhura. Pastaj lidhur me punësimin e ish-drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në shërbimin civil tha se kjo është bërë në harmoni me ligjin, dhe se nuk i takon kuvendit të merret me këtë çështje pasi që me këtë duhet të merren organet kompetente.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës – tha se propozimi për rishikimin e buxhetit të komunës ka ardhur me vonesë nga Ministria e Financave dhe për këtë nuk është fajtor drejtorja për vonesat që janë shkaktuar në procedimin e këtij propozim-vendimi. Mandej lidhur me punësimin e drejtorit të arsimit, njoftoi se nuk është e vërtetë që ai është vetëpunësuar, sepse atë konkurs e ka shpallur kryetari i komunës dhe se kjo pozitë ka qenë vakante, dhe drejtori në fjalë ligjërisht ka pasur të drejtë të konkurrojë për atë vend pune.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive dhe anëtarët e kuvendit kanë të drejtë të paraqesin pika në të ndryshme për futje në rend të ditës, andaj në këtë rast arsyetoi se futja në rend të ditës e çështjes të rishikimit të buxhetit, është e drejtë dhe shumë e nevojshme me qëllim të respektimit të afatit ligjor.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 19 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 24.04.2017;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 27.04.2017;
3. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2017-2019;
4. Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2016/2017;
5. Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe çmimeve tjera për nder të 17 qershorit Ditës së çlirimit;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e zyrës së turizmit;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rithelimin e Arkivit Komunal të Vushtrrisë;
9. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
10. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Muzeut Historik-Etnografik në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
11. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe Valleve “Hasan Prishtina” Vushtrri (**shqyrtimi i parë**);
12. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Arkivit të Komunës së Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
13. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Bibliotekës Komunale “Naim Frashëri” (**shqyrtimi i parë**);
14. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rishikimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017;
 - b). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për Sala Ajetin;
 - c). Shqyrtimi i kërkesës lidhur me ndërmarrjen “Stacioni i autobusëve” në Vushtrri.

1.Shqyrtimi dhe aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 24.04.2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi ekstraktin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 24.04.2017.

2.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 27.04.2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 27.04.2017.

3.Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2017-2019

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2017-2019.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 qershor 2017 dhe zgjat deri më 23 qershor 2017.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria e Arsimit që si propozues i draft-planit në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet Drejtoria e Arsimit, që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft- planit në fjalë, në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2017.

4.Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2016/2017

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se bursat kësaj here janë ndarë në mënyrë paksa më të drejt dhe shtoi se disa studentë kanë shfaqur ankesat e tyre për siç thonë se në lista nuk është paraqitur nota mesatare, dhe kjo sikur lë dyshime se studentët me notë më të ulët mesatare kanë përfituar bursa.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – si anëtare e komisionit për ndarjen e bursave, njoftoi se bursat për studentë janë ndarë në bazë të kriterëve të përcaktuara në rregulloren në fuqi dhe se gjithçka ka qenë transparente në ndarjen e këtyre bursave.

Agim Miftari, zyrtar i Drejtorisë së Arsimit - paraqiti sqarime lidhur me procesin e ndarjes së bursave, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

5.Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – tha se shkatërrimi i pyjeve, nga prerja, është faktor që ndikon në ndotjen e ambientit, pasi që siç thuhet që pyjet janë “mushkëria e qytetit”, andaj për

këtë duhet të kemi kujdes të posaçëm në mbrojtën e pyjeve dhe hapësirat gjelbëruese. Lidhur me informatën në fjalë ajo vlerësoi se komuna duhet të bëjë të pamundurën për t'i mbrojtur pyjet duke e ditur rëndësinë e tyre. Andaj kur bëhet fjalë për ruajtjen e pyjeve gjashtë punëtorë janë shumë pak prandaj ky numër duhet të rritet me qëllim që të kemi mbrojtje më efektive të pyjeve.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – pyeti se para një kohe, kemi pasur vënie të qëllimshme të zjarreve ndaj pyjeve, andaj në këtë drejtim a janë identifikuar këta kryerës dhe nëse po, cilat masa janë ndërmarrë ndaj tyre. Gjithashtu pyeti se a ka filluar procesi për ripyllëzimin ashtu siç ka qenë e planifikuar.

Arta Haxhaj, drejtoreshë e DBZHR-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe çmimeve tjera për nder të 17 qershorit Ditës së Çlirimit

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që Abaz Shytit t'i ndahet një mirënjohje për kontributin e tij në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithashtu propozoi që mirënjohje ti ndahet edhe Enver Isufit, babi i dëshmorit Ekrem Isufi

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – propozoi për mirënjohje Selvete Shollën për kontributin e saj në fushën e arsimit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se për të gjitha propozimet e bëra për mirënjohje duhet të jepet një biografi për secilin kandidat që i ndahet mirënjohja me qëllim që të kemi një pasqyrë se kënd po e nderojmë me mirënjohje.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, për nder të „Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, më 17 qershor 2017 nderohen me mirënjohje:

- 1.1 Ismet Kurti, postmortum, veteran i luftës së UÇK-së;
- 1.2 Sylva Hasani, veteran i luftës së UÇK-së;
- 1.3 Safet Hasani, invalid i luftës së UÇK-së;
- 1.4 Bejtush Beqiri, invalid i luftës së UÇK-së;
- 1.5 Ramadan Ademi, veprimtar i shquar, prind i dëshmorit dhe i martirit;
- 1.6 Beqir Fazliu, veprimtar i shquar, prind i dëshmorit;
- 1.7 Sadik Hasani, i burgosur politik;
- 1.8 Jakup Shyti, i burgosur politik;
- 1.9 Mahmut Sylva, veprimtar, udhëheqës i shoqatës të martirëve;
- 1.10 Abaz Shyti, për kontribut për çështjen kombëtare, veteran i luftës së UÇK-së;

1.1 Selvete Sholla, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, aktiviste dhe veterane e arsimit;

1.12 Enver Isufi, veprimtar i shquar, prind i dëshmorit;

2. Titulli “Nderi i qytetit” i ndahet gjeneral Rrahman Ramës, ish-komandant i Zonës Operative të Shalës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e zyrës së turizmit

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet Zyra e Turizmit në Vushtrri, e cila harton guidat e qytetit dhe ua ofron vizitorëve.

2. Lokacioni i zyrës i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në objektin e improvizuar në Kalanë e Qytetit në Vushtrri.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rithemelimin e Arkivit Komunal të Vushtrrisë

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se nuk duhet të kemi rithelimin të Arkivit Komunal të Vushtrrisë, por në këtë rast do të mund të bëhej ndryshimi i vendimit të atëhershëm kur është themeluar ky arkiv, andaj në këtë rast kërkoi që anëtarët e kuvendit ta kenë vendimin me të cilin është themeluar Arkivi Komunal i Vushtrrisë dhe kështu të dihet se për çfarë ndryshimesh po bëhet fjalë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se në KPF është votuar që të bëhet rithelimi i Arkivit Komunal të Vushtrrisë dhe shtoi se në konsultim me Drejtorinë e Kulturës, jemi njoftuar se nuk ka vendim për themelimin e këtij arkivi.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se nëse nuk ka pasur një vendim të mëhershëm për themelimin e këtij arkivi, atëherë në bazë të cilit dokument ka funksionuar ky arkiv. Në këtë rast ai propozoi që kjo çështje të analizohet dhe e njëjta të aprovohet e kompletuar në mbledhjen e radhës së kuvendit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

9. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 qershor 2017 dhe zgjat deri më 23 qershor 2017.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet Drejtoria e Kulturës që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2017.

10.Shqyrtimi i Draft-rregullores për Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Muzeut Historik-Etnografik në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Muzeut Historik-Etnografik të Komunës së Vushtrrisë.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 qershor 2017 dhe zgjat deri më 23 qershor 2017.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet Drejtoria e Kulturës që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2017.

11.Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Ansambllit Komunal të Këngëve dhe Valleve “Hasan Prishtina” Vushtrri (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Ansambllit Komunal të Këngëve dhe Valleve “Hasan Prishtina” Vushtrri.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 qershor 2017 dhe zgjat deri më 23 qershor 2017.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet Drejtoria e Kulturës që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2017.

12.Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Arkivit të Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi: që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

13.Shqyrtimi i Draft-rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Bibliotekës Komunale “Naim Frashëri” (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Bibliotekës Komunale “Naim Frashri” në Vushtrri.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 qershor 2017 dhe zgjat deri më 23 qershor 2017.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet Drejtoria e Kulturës që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2017.

14.Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rishikimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se në kuadër të rishikimit të buxhetit duhet të futet edhe propozimi nga Drejtoria e Urbanizmit, tek asfaltimi i rrugës në fshatin Reznik, lagjet “Curri, Makiqi Mustafa” dhe në fshatin Shalle, kodi 45592, ky projekt të bëhet projekt dyvjeçar, pastaj projekti 41423 “harta zonale” të bëhet gjithashtu projekt dyvjeçar. Mandej projekti asfaltimi i rrugës në fshatin Maxhunaj lagjja “Met Istrefi” kodi ekonomik 4575 të merren mjetet financiare në vlerë prej 30,000.00 € nga kategoria investime kapitale, pozicioni ndërtimi i kanalizimeve.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – pasi paraqiti vërejtjet sa i përket dërgimit të materialit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, ceku se projekti tek lagjja “Curri”, lagjja “Makiqi” tek shkolla e fshatit Reznik, projekt i cili ishte paraparë vitin e kaluar kur ishte aprovuar buxhetit i komunës, kurse ky projekt nuk është realizuar, dhe tani ky projekt nuk është futur, andaj kërkoi që në kuadër të rishikimit të buxhetit të futet asfaltimi i asaj rruge dhe ky projekt mos të jetë dyvjeçar por këtë vit të përfundoj, d.m.th emërtimi të jetë lagjja “Makiqi” – shkolla në gjatësi 200 m.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – kërkoi sqarime lidhur me projektin e ndërtimit të kanalizimit në fshatin Maxhunaj dhe gjithashtu parashtrroi shqetësimin e banorëve të këtij fshati për rrezikun që paraqet mungesa e trotuarit në rrugën “Paqja” që fillon nga rruga magjistrale Mitrovicë-Prishtinë e deri tek shkolla e këtij fshati.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 2 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017 në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2017, i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

2.Mjetet e rishikuara sipas pikës 1 të këtij vendimi barten sipas tabelës 1, 1.A dhe 2, 2.A që janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për Sala Ajetin

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se pas konsultave që ka pasur me kryetarin e komunës është marrë vesh që të merret një vendim për ofrimin e ndihmës financiare në vlerë prej 1000 € për Sala Ajetin.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – propozoi që kjo ndihmë financiare të jetë në vlerë prej 2000 €.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për subvencione dhe transfere, për Sala Ajetin me banim në fshatin Stanoc i Poshtëm të Komunës së Vushtrrisë, në shumën prej 2000 € (dy mijë euro).

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahen me qëllim të shërimit të vajzës së saj Hamide Ajeti.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

c). Shqyrtimi i kërkesës lidhur me ndërmarrjen “Stacioni i autobusëve” në Vushtrri.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se pasi që personi privat e ka fituar këtë kontest gjyqësor lidhur me pronën në fjalë, është mirë që të merret një vendim që shenja e stacionit të autobusëve të hiqet nga PZHK-ja dhe kështu këtyre pronarëve do t’u mundësohej shfrytëzimi i asaj prone.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se e përkrah kërkesën e këtyre banorëve, për faktin se është legjitime që ata banorë ta shfrytëzojnë pronën e vet. Gjithashtu vlerësoi se kjo tregon që PZHK është aprovuar dhe zona e tetë ka mbetur zonë ndërtimore.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se në emër të grupit kuvendar të LDK-së do ta përkrahin kërkesën për heqjen e shenjës së emërimit të stacionit të autobusëve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se akoma nuk kemi konfirmim zyrtar nga ana e ministrisë gjegjëse se a është aprovuar Plani Zhvillimor Komunal apo jo, dhe kjo pritet të konfirmohet në të ardhmen. Pastaj shtoi se me gjithë respektin për palën që ka parashtruar këtë kërkesë, kjo është dashur të shkojë përmes drejtorisë kompetente me qëllim që kjo çështje të jetë plotësisht zyrtare. Tutje vlerësoi se ne pajtohemi që ta heqim atë tabelë ku shënon stacioni i autobusëve, mirëpo ai stacion d.m.th objekti është rrënuar pothuajse tërësisht dhe askush nuk e di se ku e mori vendimin dhe kush e rrënoi atë objekt. Andaj për këto dhe shumë çështje tjera dikush duhet të jep përgjegjësi.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit duke iu referuar parafolësit të tij tha se çuditet me të se si nuk ka njohuri për gjërat edhe pse në të kaluarën ka udhëhequr komunën, dhe shtoi se pronat ku po kërkohet të hiqet shenja e stacionit të autobusëve, ka qenë e këtyre pronarëve që kanë parashtruar kërkesë dhe këtë pronësi e kanë dëshmuar edhe me dokumentacion. Kurse kontesti ka qenë për kompensimin e dëmit për periudhën gjatë të cilës këta pronarë nuk kanë mundur ta shfrytëzojnë pronën e tyre. Mandej ai vlerësoi se edhe në të kaluarën ka kërkuar që kjo shenjë e stacionit të autobusëve të hiqet dhe pronarëve t’u jepet mundësi që ta shfrytëzojnë pronën e tyre. Në fund tha se është mirë që pronarët e këtyre pronave kanë hequr dorë nga padia dhe po arrihet ujdia gjyqësore lidhur me kontestin e kompensimit të dëmit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se në kohën kur ai ka qenë kryetar i komunës, pronat e stacionit të autobusëve kanë qenë nën menaxhimin e AKM-së, e që i bie që komuna nuk ka pasur autorizime për të menaxhuar me ato prona, si dhe në të njëjtën kohë ka ekzistuar edhe administratori ndërkombëtar i cili ka qenë shumë i fuqishëm me kompetenca dhe ai si kryetar nuk mundur të bëjë pothuajse asgjë sa i përket menaxhimit të atyre pronave.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim hiqet shenja (tabela) e emërimit të ish-ndërmarrjes Kosova-Trans “Stacioni i autobusëve” në Vushtrri, nga Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë 2016-2024.

2. Për zbatimin e këtij vendim obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

ç). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:


Agim Bregaj, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e tij sa i përket punësimeve në administratën komunale dhe shprehu dyshimet e tij për panelet intervistuese, të cilat nuk janë objektive dhe janë të anshme. Pastaj vlerësoi se për të marrë një vend pune duhet të kesh lidhje familjare dhe t'i përkasësh partisë politike që udhëheq në pushtet, apo duhet të jesh “militant” politik. Konkretisht ai ceku një konkurs që është hupur për pranimin e stafit mjekësor, në ç’ rast janë bërë shkelje drastike të rregullores dhe ligjit në fuqi lidhur me pranimin e këtyre punëtorëve. Andaj lidhur me këtë kërkoi nga paneli intervistues që të analizojë në hollësi ato kërkesa dhe pyetje që janë parashtruar në atë test, përndryshe ky konkurs duhet të anulohet.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – duke iu referuar emisionit televiziv “Jeta në Kosovë” dhe disa portaleve lokale, ceku se kanë shpërfaqur skandalin në QKMF, përkatësisht laboratorin e analizave, ku punëtorët e këtij laborator refuzojnë t’i përfillin rregullat dhe vendimit e menaxhmentit të QKMF-së. Pastaj janë ngritur shqetësimet se në këtë laborator nuk kryhen një numër i analizave sipas standardeve, raportet e analizave nuk nënshkruhen nga shefi i laboratorit, ka dëgjuar mjaft ankesa nga pacientët që i janë bërë analizat gabimisht ku njëri nga pacientët ka denoncuar se i janë bërë gabimisht analizat e sheqerit. Pastaj duke iu referuar një shkrimi të drejtorit, ku kishte deklaruar se: Në laboratorin e analizave janë bërë mjaft investime, porse edhe atëherë kishte pasur rezistencë nga stafi i laboratorit për të mos e shtuar numrin e analizave në laborator. Andaj në këtë rast pyeti Drejtorinë e Shëndetësisë se çfarë masash janë ndërmarrë ndaj personelit të laboratorit që kanë refuzuar të bëjnë shtimin e analizave në laborator, a jeni informuar nga drejtoria e QKMF-së për punën në laborator, a iu ka informuar shefi i laboratorit për punën në laborator, a është shkarkuar shefi i laboratorit dhe çfarë ka punuar shefi i laboratorit deri në shkarkim, a është raportuar se në laborator pihet duhani dhe çfarë masash janë ndërmarr për ndalimin e këtyre veprimeve, sa vite ka funksionuar laboratori pa shef, me çfarë konkursi është emëruar shefi i laboratorit dhe kur.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit – kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të rregullohet shtrati i lumit “Podranqa” për faktin se shtëpitë përgjatë këtij lumi po rrezikohen nga vërshimi i ujërave të zeza.


Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit